



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-06

Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatësi Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 16 dhjetor 2020

Gjuha: anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi kryerjen e rishikimit të paraburgimit dhe ndryshimin e afatit për mocionet paraprake

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Dejvid Hupër

Mbrojtësit të Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenin 41(10) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 9(5), 57(2), 95(2)(d) dhe 97(2) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Midis 9 dhe 11 nëntorit 2020, në përputhje me rregullën 92 të Rregullores, u mbajtën paraqitjet e para për Jakup Krasniqin ("z. Krasniqi"),² Hashim Thaçin ("z. Thaçi"),³ Kadri Veselin ("z. Veseli"),⁴ dhe Rexhep Selimin ("z. Selimi") (individualisht dhe bashkërisht "të akuzuarit").⁵

2. Më 18 nëntor 2020, në përputhje me rregullën 96(1) të Rregullores, u mbajt konferenca e parë mbi ecurinë e çështjes.⁶

3. Më 4 dhjetor 2020, Mbrojtja për z. Thaçi parashtrroi një kërkesë për lirim të përkohshëm, duke përfshirë edhe një kërkesë për një seancë dëgjimore në lidhje me këtë çështje. ("Kërkesa për lirim të z. Thaçi").⁷

4. Më 7 dhjetor 2020, Mbrojtja për z. Krasniqi dhe Mbrojtja për z. Selimi dorëzuan dy kërkesa për lirim të përkohshëm, duke përfshirë edhe kërkesat për seanca dëgjimore në lidhje me këtë çështje dhe për shkurtim të afatit për përgjigje dhe

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës (z. Krasniqi), 9 nëntor 2020, publik.

³ KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës(z. Thaçi), 9 nëntor 2020, publik.

⁴ KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës(z. Veseli), 10 nëntor 2020, publik.

⁵ KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës(z. Selimi), 11 nëntor 2020, publik.

⁶ KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës, 18 nëntor 2020 ("Transkripti i 18 nëntorit 2020"), publik.

⁷ KSC-BC-2020-06, F00120/RED, Mbrojtja për z. Thaçi, *Kërkesë për lirim të përkohshëm në emër të z. Hashim Thaçi*, 4 dhjetor 2020, publik.

kundërpërgjigje (“Kërkesa për lirim të z. Krasniqi” dhe “Kërkesa për lirim të z. Selimi”).⁸

5. Më 14 dhjetor 2020, në bazë të rregullës 97(1) të Rregullores (“Kërkesë e përbashkët e Mbrojtjes për ndryshim të afatit”),⁹ Mbrojtja e të akuzuarve dorëzoi një kërkesë të përbashkët për ndryshim të afatit për parashtrim të mocioneve paraprake.

6. Më 15 dhjetor 2020, sipas kërkesës së mëparshme të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,¹⁰ Mbrojtja për z. Veseli dorëzoi parashtrimet e veta lidhur me konferencën e dytë mbi ecurinë e çështjes. (“Parashtrimet e z. Veseli lidhur me konferencën mbi ecurinë e çështjes”),¹¹ e cila u planifikua të mbahet më 17 dhjetor 2020.¹² Mbrojtja për z. Veseli njofton se do të dorëzojë një kërkesë për lirim të përkohshëm para konferencës së dytë mbi ecurinë e çështjes dhe sugjeron një afat lidhur me parashtrimet e palëve.¹³

7. Më 15 dhjetor 2020, Mbrojtja për z. Thaçi dorëzoi parashtrimet e veta lidhur me konferencën e dytë mbi ecurinë e çështjes, ku përsërit kërkesën e vet për një seancë dëgjimore në lidhje me vazhdimin e paraburgimit apo lirim të z. Thaçi.¹⁴

8. Më 16 dhjetor 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi përgjigjen e vet në lidhje me kërkesën e përbashkët për ndryshim të afatit, në të cilën ZPS-ja nuk kundërshton zgjatjen prej dy javësh të afatit të përcaktuar 30-ditësh për

⁸ KSC-BC-2020-06, F00122, Mbrojtja për z. Krasniqi, *Kërkesë për lirim të përkohshëm*, 7 dhjetor 2020, konfidencial, me shtojcat 1-2, konfidenciale, dhe shtojcën 3, publike; F00124/RED, Mbrojtja për z. Selimi, *Kërkesë e Mbrojtjes për lirim të përkohshëm*, 7 dhjetor 2020, publike, me shtojcat 1-3, publike.

⁹ KSC-BC-2020-06, F00137, Mbrojtja për z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi, dhe z. Krasniqi, *Kërkesë e përbashkët e Mbrojtjes për ndryshimin e afatit për parashtrim të mocioneve paraprake*, 14 dhjetor 2020, publik.

¹⁰ KSC-BC-2020-06, F00130, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për caktim të datës së konferencës së dytë mbi ecurinë e çështjes dhe për parashtrime*, 8 tetor 2020, publik (“Urdhër për caktim date”), para. 19(c).

¹¹ KSC-BC-2020-06, F00145, Mbrojtja për z. Veseli, *Parashtrimet e Mbrojtjes për Kadri Veselin – Konferenca mbi ecurinë e çështjes*, 17 dhjetor 2020, 15 dhjetor 2020, publik.

¹² Urdhri për caktim date, para. 19(a).

¹³ Parashtrimet e z. Veselit lidhur me konferencën mbi ecurinë e çështjes, para 6-7.

¹⁴ KSC-BC-2020-06, F00143, Mbrojtja për z. Thaçi, *Mbrojtja për z. Thaçi – Parashtrime për konferencën e dytë mbi ecurinë e çështjes*, 15 dhjetor 2020, publik, para. 20.

dorëzim të mocioneve paraprake¹⁵, pas nxjerrjes së materialit të përcaktuar të rregullën 102(1)(a).

9. Më 16 dhjetor 2020, ZPS-ja dorëzoi përgjigjen e vet në lidhje me kërkesën për lirim të z. Thaçi, në të cilën ZPS-ja, ndër të tjera, kundërshton kërkesën e Mbrojtjes për seancën dëgjimore në lidhje me paraburgimin, mbi bazën se parashtrimet me shkrim nga palët, duke përfshirë përgjigjet e mundshme nga Mbrojtja, janë të mjaftueshme për Gjykatësin e Procedurës Paraprake që të marrë një vendim.¹⁶

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

10. Në përputhje me nenin 41(10) të Ligjit, deri në kohën kur aktgjykimi të marrë formën e prerë ose deri në lirimin nga paraburgimi, me kalimin e dy muajve pas aktvendimit të fundit për paraburgim gjykatësi i procedurës paraprake i informuar për rastin shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për paraburgim dhe nxjerr aktvendimin për lirimin apo ndërprerjen e paraburgimit.

11. Në përputhje me rregullën 57(2) të Rregullores, pas caktimit të gjykatësit të procedurës paraprake dhe deri kur aktgjykimi të marrë formë të prerë, paneli i angazhuar me çështjen vlerëson vendimin mbi mbajtjen në paraburgim, pasi të kenë kaluar dy (2) muaj nga vendimi i fundit në lidhje me paraburgim, në përputhje me nenin 41(6), (10), (11) dhe (12) të Ligjit, ose në çdo kohë me kërkesë të të akuzuarit ose Prokurorit të Specializuar, ose *proprio motu*, nëse që nga vlerësimi i fundit ka ndryshim të rrethanave.

12. Në përputhje me rregullën 75(2) të Rregullores, përgjithësisht dhe sipas gjykimit të panelit, vendimet në lidhje me çështje rutinore apo çështjet që nuk janë aspak, ose

¹⁵ KSC-BC-2020-06, F00147, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj kërkesës së përbashkët të Mbrojtjes për ndryshim të afatit*, 16 dhjetor 2020, publike.

¹⁶ KSC-BC-2020-06, F00149, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj kërkesës për lirim të përkohshëm në emër të z. Hashim Thaçi*, 16 dhjetor 2020, publike.

janë fare pak komplekse bëhen ose paraqiten gojarisht, dhe shoqërohen me arsyetim me shkrim kur kjo është e nevojshme.

13. Në përputhje me rregullën 75(3) të Rregullores, në qoftë se nuk përcaktohet ndryshe me një urdhër ose në Rregullore, parashtrimet me shkrim të palëve gjatë procesit gjyqësor nuk pasohen me argumentime gojore.

14. Në përputhje me rregullën 95(2)(d) të Rregullores, gjykatësi i procedurës paraprake mban seanca të nevojshme për të mundësuar procedim të drejtë dhe të shpejtë.

15. Në përputhje me rregullën 97(2) të Rregullores, i akuzuari mund t'i paraqesë mocionet paraprake me shkrim brenda tridhjetë ditësh pas nxjerrjes së të gjithë materialit dhe deklaratave të përmendura në rregullën 102(1)(a) të Rregullores.

16. Në përputhje me rregullën 9(5) të Rregullores, gjykatësi i procedurës paraprake, *proprio motu* ose nëse i tregohen arsye të vlefshme, mund të zgjasë apo shkurtojë afatet e përcaktuara nga Rregullorja ose nga gjykatësi i procedurës paraprake.

III. DISKUTIM

A. RISHIKIMI I PARABURGIMIT

1. Kërkesat për seancë dëgjimore

17. Mbrojtja për të gjithë të akuzuarit kërkon nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake të planifikojë një seancë dëgjimore në mënyrë që të lejojë palët të paraqesin parashtrimet e veta nëse ende ekzistojnë arsyet për vazhdim të paraburgimit të të akuzuarve, apo nëse duhet urdhëruar lirimi, me ose pa kushte.¹⁷ Mbrojtja argumenton se seanca dëgjimore për çdo të akuzuar do të lejojë palët të shtjellojnë si duhet aspekte të rëndësishme sikurse vazhdimi i paraburgimit apo lirimi, të përgjigjen në lidhje me

¹⁷ Kërkesa për lirim e z. Thaçi, para. 70; Kërkesa për lirim e z. Selimi, para. 49; Kërkesa për lirim e z. Krasniqi, para. 53; Parashtrimet e z. Veseli lidhur me konferencën mbi ecurinë e çështjes, para. 7.

çështje të papërfunduara, ose t'u përgjigjen pyetjeve të Gjykatësit të Procedurës Paraprake.¹⁸

18. Gjykatësi i Procedurës Paraprake, thekson se, brenda kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara, disa seanca janë rreptësisht të domosdoshme duke marrë parasysh natyrën e çështjeve që duhet trajtuar, sikurse paraqitjet e para¹⁹ të të dyshuarve dhe të akuzuarve ose konferencat mbi ecurinë e çështjes për sa i përket nxjerrjes së provave.²⁰ Në raste të tjera, Rregullorja lejon që mbajtja e seancave të caktohet sipas gjykimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, posaçërisht nëse është e domosdoshme për të mundësuar procedime të drejta dhe të shpejta, sikurse përcaktohet në rregullën 95(2)(d) të Rregullores.

19. Në këtë rast, Gjykatësi i Procedurës paraprake vë në dukje parashtrimet e shumta dhe shteruese me shkrim nga Mbrojtja lidhur me këtë çështje, të cilat do të shqyrtohen më tutje duke pasur parasysh përgjigjen (përgjigjet) e ZPS-së. Gjithashtu, Mbrojtja do të ketë mundësinë të parashtrojë kundërpërgjigje ndaj përgjigjeve të ZPS-së, për sqarimin e pozitës individuale përkatëse të secilit të akuzuar. Bazuar në sasinë e mjaftueshme të informacioneve që do të paraqiten, vendimi vetëm në bazë të parashtrimeve me shkrim mbi secilën kërkesë për lirim nga Mbrojtja, në këtë rast, nuk do të cenojë të drejtat e të akuzuarve dhe drejtësinë dhe shpejtësinë e këtij procedimi. Për këtë arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, konsideron se parashtrimet me gojë në lidhje me vazhdimin apo lirimin e të akuzuarve nuk janë të domosdoshme.

¹⁸ Kërkesa për lirim e z. Thaçit, para 70-71; Parashtrimet e z. Veselit lidhur me konferencën mbi ecurinë e çështjes, para. 7; Kërkesa për lirim e z. Selimi, para 49, 51(c); Kërkesa për lirim e z. Krasniqi, para 53-54(c).

¹⁹ Neni 41(5) i Ligjit; rregulla 92 e Rregullores.

²⁰ Rregulla 96 e Rregullores.

2. Kërkesat për afat të përshpejtuar lidhur me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet

20. Mbrojtja për z. Selimi dhe Mbrojtja për z. Krasniqi kërkojnë një afat të përshpejtuar lidhur me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet në mënyrë që të gjitha debatet ligjore me shkrim të kryhen para seancës dëgjimore përkatëse të kërkuar dhe gjithashtu para se të fillojë pushimi i gjykatës.²¹

21. Gjykatësi i Procedurës Paraprake, thekson se kërkesat e Mbrojtjes për këtë lidhen me kërkesat e tyre për seancë. Pas konstatimit se kjo e fundit nuk është e domosdoshme në këtë rast, Gjyqtari i Procedurës Paraprake konsideron se, një afat i përshpejtuar për përgjigje dhe kundërpërgjigje nuk është më i nevojshëm. Meqë procedura e rishikimit të paraburgimit të të akuzuarve do të kryhet tërësisht me shkrim dhe ZPS-ja duhet t'u përgjigjet parashtrimeve të të katër akuzuarve, nevojiten ditët e plota siç është përcaktuar në rregullën 76 të Rregullores, që palëve t'u mundësohet shtjellimi i duhur i pikëpamjeve të veta përkatëse.

3. Kërkesa e z. Veseli për afat të zgjeruar lidhur me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet

22. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se z. Veseli është në paraburgim nga arrestimi i tij më 5 nëntor 2020. Në pajtim me nenin (10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores, rishikimi i parë i mbajtjes së tij në paraburgim bëhet pasi të kenë kaluar dy muaj nga zbatimi i vendimit të fundit në lidhje me paraburgim, gjegjësisht fletarrestimi i lëshuar për z. Veseli. Rrjedhimisht, afati për këtë rishikim është e martë, 5 janar 2021.

23. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje afatin e sugjeruar nga Mbrojtja për z. Veseli, sipas të cilit ZPS-ja duhet të dorëzojë përgjigjen e vet ndaj kërkesës së ardhshme lidhur me lirim të përkohshëm të z. Veseli deri të enjten, më 31 dhjetor 2020, ndërsa Mbrojtja për z. Veseli duhet të dorëzojë kundërpërgjigjen deri të hënë, më 11

²¹ Kërkesa për lirim e z. Selimi, para. 50; Kërkesa për lirim e z. Krasniqi, para. 52.

janar 2021.²² Si rrjedhojë, afati i sugjeruar tejkalon afatin dymujor të përcaktuar në nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores.

24. Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se, për arsye të drejtësisë, palëve u nevojitet koha e plotë e përcaktuar në rregullën 76 të Rregullores për të bërë parashtrimet, sikurse pasqyrohet në afatin e sugjeruar nga Mbrojtja për z. Veseli, gjë që tejkalon afatin e zakonshëm në lidhje me përgjigjet (10 ditë) dhe kundërpërgjigjet (5 ditë) sipas rregullës 76 të Rregullores. Në të njëjtën kohë, zbatimi i afatit sipas rregullës 76, do të shkaktonte presion të tepruar mbi palët gjatë pushimit dimëror të afërt.

25. Duke pasur parasysh afatin e sugjeruar nga Mbrojtja për z. Veseli, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se, në këtë rast i akuzuari synon të heqë dorë nga e drejta e tij për rishikim të mbajtjes në paraburgim brenda afatit dymujor siç përcaktohet në nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores.

26. Rrjedhimisht, me kusht që kërkesa e z. Veseli të dorëzohet më 17 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e konsideron të përshtatshme që ZPS-ja të dorëzojë përgjigjen e vet lidhur me kërkesën e ardhshme për lirim të përkohshëm nga Mbrojtja për z. Veseli deri të hënën, më 4 janar 2021, dhe që Mbrojtja të dorëzojë kundërpërgjigjen e vet deri të hënën, më 11 janar 2021. Pasi të ketë dëgjuar nga palët, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos, sa më shpejt që të jetë e mundur, mbi vazhdimin e paraburgimit ose lirimin e të akuzuarit.

4. Versioni publik i redaktuar i kërkesës për lirim të z. Krasniqi

27. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se Mbrojtja për z. Krasniqi ka parashtruar kërkesën e vet për lirim vetëm në version konfidencial. Me qëllim që të

²² Parashtrimet e z. Veseli lidhur me konferencën mbi ecurinë e çështjes, para. 7.

respektohet parimi i publicitetit, Mbrojtja për z. Krasniqi duhet të paraqesë versionin publik të redaktuar të kërkesës së vet deri të premtën, më 18 dhjetor 2020.

B. MOCIONET PARAPRAKE

28. Mbrojtja për të akuzuarit kërkon bashkërisht që, brenda kuptimit të rregullës 97 të Rregullores, afati për parashtrim të mocioneve paraprake të zgjatet deri më 10 shkurt 2021.²³ Mbrojtja argumenton se ekzistojnë arsye të vlefshme për kërkesën e zgjatjes, duke marrë parasysh numrin e të akuzuarve në këtë çështje dhe fushëveprimin e akuzave, vëllimin e provave të nxjerra kohëve të fundit dhe kufizimet e krijuara nga pandemia lidhur me COVID-19, gjë që ndikon në konsultimet me të akuzuarit.²⁴

29. Gjykatësi i Procedurës Paraprake, rikujton se në përputhje me rregullën 97(2) të Rregullores, afati për parashtrim të mocioneve paraprake është 11 janar 2020. Gjykatësi i Procedurës paraprake vëren se në pajtim me rregullat 102(1)(a) dhe 103 të Rregullores, midis 10 dhe 15 dhjetorit 2020, Mbrojtja mori një numër të madh provash, gjë që efektivisht shënon fillimin e nxjerrjes së provave në këtë çështje. Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka parasysh kohën që nevojitet për analizim të provave voluminoze të nxjerra dhe për t'i diskutuar ato me të akuzuarit, duke përfshirë edhe gjatë kohës së pushimit dimëror të ardhshëm, si dhe kufizimet në punën e Mbrojtjes të krijuara nga pandemia në lidhje me COVID-19. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ekzistojnë arsye të vlefshme që të zgjasë afatin për parashtrim të mocioneve paraprake deri të mërkurën, më 10 shkurt 2021, në përputhje me rregullën 9(5) të Rregullores dhe brenda kuptimit të rregullës 97 të Rregullores.

²³ Kërkesa e përbashkët e Mbrojtjes për ndryshimin e afatit, para. 11.

²⁴ Kërkesa e përbashkët e Mbrojtjes për ndryshimin e afatit, para 6, 10.

Hagë, Holandë.